



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 1032/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Minerva Dërmaku kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë ngasubjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë paraqitur kundër Komisionit Qëndror Zgjedhor (KQZ), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunalë në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

#### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Minerva Dërmaku kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë në Prishtinë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

#### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Minerva Dërmaku kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga PDK-ja në Prishtinë në të cilën pretendon se është bërë shkelje gjatë numërimit të votave sepse në Qendrën e Vendvotimit (QV), 1910E/01R minimumi i votave duhen me qenë 30 vota, ndërsa në listën zyrtare janë 10, prandaj kërkon që të paktën për Qendrën 1910E/01R që t'i lejohet hapja dhe kontrollimi i votave si dhe procedurave të votuara.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtuesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-i lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 1032/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24( njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.